

Statistikat e Transportit Hekurudhor

Tremujori II, 2024


Tiranë, më 30 Korrik 2024: Gjatësia e rrjetit hekurudhor në shfrytëzim në vend është 253 km. Në shfrytëzim janë linjat hekurudhore: Kufi - Gjorm 93 km, Durrës - Elbasan 76 km, Rogozhinë – Fier 49 km dhe Fier – Vlorë 35 km. Transporti hekurudhor i mallrave kryhet në distanca 0 - 49 km dhe 50 - 150 km.

Statistikat e Transportit hekurudhor, për tremujorin e dytë 2024, paraqiten si në vazhdim:

Volumi i mallrave të transportuara nëpërmjet rrugëve hekurudhore është 143 mijë ton, duke shënuar rritje me 2,8 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2023.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në mijë ton-km rezultoi 4.728 nga 4.761 mijë ton-km në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke u ulur me 0,7 %.

Fig. 1: Transporti hekurudhor i mallrave, 000/ton-km



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

"Qymyri dhe linjiti, nafta bruto dhe gazi natyror" sipas klasifikimit NST 2007 (Nomenclatura e Statistikave të Transportit), zënë 88,1 % të mallrave të transportuar me hekurudhë , "Lëndë të para të ricikluara; mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturina të tjera" 7,3 % "Metalet bazë; produktet metalike të fabrikua, përveç makinerive dhe pajisjeve" zënë 4,6 % (tab.1).

Për publikim 30/07/2024


Tab. 1: Mallra të transportuara me hekurudhë sipas NST 2007, në 000/ton

| Nr | Kategoritë e mallrave të transportuara në hekurudhë | Mallra gjithsej në 000/ton | |
|----|--|----------------------------|--------------|
| | | Tr II-2024 | % |
| | Gjithsej | 143,3 | 100,0 |
| 1 | Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror | 126,2 | 88,1 |
| 2 | Metale bazë; produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve | 6,6 | 4,6 |
| 3 | Lëndë të para të ricikluara; Mbetjet e ngurta (bashkiake) dhe mbeturinat e tjera | 10,5 | 7,3 |

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

Në tremujorin e dytë 2024, kanë përdorur transportin hekurudhor si mjet udhëtimi 4.091 pasagjerë, duke shënuar rritje me 24,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Fig. 2: Numri i pasagjerëve në transportin hekurudhor, 000 pasagjerë/km



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

Eksportet/importet e mallrave me hekurudhë

Në tremujorin e dytë 2024, volumi i mallrave të tregtuara me hekurudhë (eksport dhe import) është 1.936 tonë. Volumi i mallrave të eksportuara me hekurudhë zë 0,1 % ndaj volumit gjithsej të mallrave të eksportuara në vend.

Tab. 2: Eksportet/importet e mallrave me hekurudhë, ton

| Periudha | TR II-2022 | TR III-2022 | TR IV-2022 | TR I-2023 | TR II-2023 | TR III-2023 | TR IV-2023 | TR I-2024 | TR 2-2024 |
|----------|------------|-------------|------------|-----------|------------|-------------|------------|-----------|-----------|
| Eksporti | 1.104 | 720 | 0 | 2.784 | 4.622 | 2.706 | 2.037 | 595 | 1.936 |
| Importi | 1.113 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritjet INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë tremujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit hekurudhor, tokësor, detar dhe ajror.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve që përdorin një automjet hekurudhor në një rrjet të caktuar hekurudhor.

Gjatësia e shinave: Për një seksion të caktuar hekurudhor është gjatësia midis pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të nisjes dhe pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të terminalit.

Pasagjerë të transportuar me hekurudhë: Do të quhet çdo pasagjerë që udhëton me mjetin hekurudhor, duke përfshirë personat e destinuar për shërbime në tren.

Ton-kilometër (TKM) - Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një ton kapaciteti të disponueshëm në një vagon kur kryhet shërbime për të cilat është përcaktuar një distancë kryesisht mbi një kilometër.

Mallra të transportuara me hekurudhë - Do të quhet çdo lëvizje malli që kryhet me mjet hekurudhor, duke përfshirë këtu ambalazhin dhe pajisjet siç janë kontenerët, paletet si dhe mjetet rrugore të mallrave të transportuara me hekurudhë.

Tren-kilometër - janë distancat në kilometra të përshkuara nga trenat.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i katërt, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i katërt, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: transport rrugor, hekurudhë, transport ujor i brendshëm dhe transport detar.

Të dhënat e transportit hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash

Për t'u konsultuar me botime të tjera. vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>